



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

LËNDA: FTESË PËR OFERTË PËR ORGANIZIM EVENTESH

Të nderuar,

Nëpërmjet kësaj letre, ju ftojmë të paraqesni ofertën tuaj lidhur me shërbimin e “Organizimit të Eventeve” pranë të zyrave të QShPZh m në kuadër të procedurave të prokurimit që do të zhvillohen nga organizata Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh).

Informacion i përgjithshëm rreth QShPZh

QShPZh-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

Si anëtare me të drejta të plota e Federatës Ndërkombëtare të Planifikimit Familjar (IPPF) dhe si Partner Zbatues i Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH) zbaton një sërë aktivitetesh si trajnime, seminare, konferenca, tryeza të rrumbullakëta që kanë qëllim të përmbushin misionin e saj në përputhje me mandatet e këtyre donatorëve me fokus shëndetin seksual dhe riprodhues, dhunën me bazë gjinore dhe atë seksuale dhe fuqizimin e grave si edhe çështjet demografike. Në kuadër të programeve të mbështetura nga UNFPA dhe IPPF për vitin 2021, për të organizuar këto aktivitete dhe ofruar shërbime si sigurimi i vakteve, sigurimi i ambjenteve/sallave për përdorim, pushimeve të kafesë, transportit, akomodimit etj. QSHPZH shpall thirrjen për ofertë nga operatorë të ndryshëm që ofrojnë shërbimin e “Organizimit të Eventeve” në të gjithë Shqipërinë.

TERMA REFERENCE

1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Synimi i përgjithshëm është ndriçimi i zyrave të QShPZh dhe Qendrës PO për të siguruar mbarëvajtjen dhe punën e stafit.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Objekti

- Blerja e produkteve dhe shërbimeve të kërkuara janë sipas listës në vijim:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi /njësi (ALL)	Vlera (ALL)
1	Qira salle e vogël	Ditë	1	15, 000	15,000
2	Pushim Kafeje (10-25) persona	Pers	25	400	10,000
3	Dreka Open buffet	Pers	25	1300	32,500
4	Dreka Cattering	Pers	25	800	20,000

2. Data dhe Vendi

Me kërkesë të organizatës, ofertat e produkteve dhe shërbimeve do të dorëzohen në Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë. Tel: +042251475, brenda orës 16:30.

3. Profili i kërkuar i aplikantit

1. Subjekt tregtari i regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi.

4. Përzgjedhja dhe Tarifat

*Qendra Shqiptare per Popullsinë dhe Zhvillimin(QSHPZH)
Bulevardi “Gjegj Fishta, Nd.26, H.6, Ap5, 1001,Tiranë, Shqipëri.*



QENDRA SHQIPTARE PËR POPULLSINË DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Operatori ekonomik i cili do të përzgjidhet për ofrimin e shërbimit të lartë përmendur, do ti kryhet pagesa pas dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve dhe faturës përkatëse në llogarinë bankare të subjektit.

5. Aplikimi

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë).

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- NIPT, Ekstrakt historik
- Oferta Financiare përfshirë TVSH për shërbimin që kërkohet.

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për ofertën më të ulët financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

Për çdo pyetje, ju lutem mos ngurroni ti adresoni në adresën e email: info@acpd.org.al